

FILLO NGA SOT



PËR TË NESËRMEN

DEMOKRACINË NUK E PËRBËJNË DISA PERSONA, AJO PËRBËHET NGA TË GJITHË

ARDIT (14), ARJANIT (14), ERISA (14), SYMEA (14), OLTİ (14), MEDINA (14)



Demokracia nuk mund të zhvillohet pa shprehjen e lirë. Të diskutosh dhe të votosh, të mblidhesh dhe të kundërshtosh, të kesh lirinë për të ushtruar besimin lirshëm dhe të sillemi drejt me njëri-tjetrin janë disa nga mënyrat ideale për zhvillimin e demokracisë. E si u zhvillua demokracia që prej kohës kur u shfaq e deri sot, do të mësoni në artikullin tonë

Eh moj demokraci, sa shpejt u rrite dhe u zhvillove. Por, nuk u zhvillove vetëm, bashkë me ty u zhvilluan edhe shumë shtete. E një ndër ta, edhe shteti ynë Kosova.

Të dashur bashkëmoshatarë, ju jeni shumë me fat, sepse edhe ju sot do të mësoni shumë gjëra që ne sapo i mësuam për demokracinë. Do të mundohemi që t'i transmetojmë shumicën prej atyre që i shohim si shumë të domosdoshme, në mënyrë që të gjithë ju të jeni në dijeni për to. Po ashtu, do t'iu tregojmë se pse është e rëndësishme të mësojmë për këtë sistem. Demokracia si sistem apo si formë e qeverisjes ka lindur shumë moti. Thënë më mirë, është shfaqur shumë kohë më parë. Më saktësisht, në vitin 507 p.e.s. në qytetin e Athinës. Ajo erdhi si nevojë e popullit athinas për të marrë vendime. Vendi ku mblidheshin qytetarët për të shqyrtuar dhe marrë vendime ishte Asambleja, e cila përbëhej nga 5000 deri në 6000 anëtarë, edhe pse shteti i Greqisë kishte numër të qytetarëve më të madh. Në mbledhjet e Asamblesë kishin të drejtë të merrnin pjesë vetëm fisnikët. Ndërsa, qytetarët të cilët ishin të varfër nuk e gëzonin këtë të drejtë. Po ashtu, as gratë dhe as pleqtë nuk kishin të drejtë të merrnin pjesë në vendimmarrje (e se si u fitua dhe u zhvillua e drejta e votës edhe për gjininë femërore, do të lexoni

në artikullin e shokëve dhe shoqeve tona).

Ani pse ishte demokraci, prapëseprapë nuk ishin të gjithë të barabartë. Gjë që sot ky fenomen nuk është i pranishëm fare. Në kohët e sotme, të gjithë qytetarët i gëzojnë të drejtat e barabarta, duke përfshirë këtu gratë, pleqtë dhe qytetarët të cilët nuk kanë kushte të mira ekonomike. Parimisht, para ligjit të gjithë jemi të barabartë dhe duhet të trajtohem në mënyrë të tillë. Qytetarët janë të lirë të shprehen lirshëm, janë të lirë të jenë vetvetja, janë të lirë të ushtrojnë besimin e tyre lirshëm, etj.

Kjo është demokracia sot, shumë më e zhvilluar, më e mirë dhe më e drejtë se në të kaluarën. Ky sistem nuk është i plotë, nëse të gjithë qytetarët nuk trajtohen në mënyrë të barabartë. Barazia është demokraci!



Edhe ne jemi pjesë e demokracisë

VOTA, E DREJTA IME

DONJETA (15), ERZA (14), VALENTINA (16), LEARTI (14)



Ne jemi nxënës të shkollës “Hilmi Rakovica”, dhe përmes këtij tregimi do të kuptoni më shumë për procesin zgjedhor, i cili ndodh në shtetet demokratike

Muajin e kaluar mbusha 18 vjet dhe unë u gëzova shumë. Tanimë ndihesha më e pjekur dhe mund të vendosja më shumë për veten. Familjarët më treguan se javën e ardhshme do të kishte zgjedhje në vendin tonë dhe unë do të mund të votoja kësaj here, sepse që nga mosha 18 vjeçare e fitoja të drejtën e votës. Kaluan ditët dhe erdhi koha të votojmë të gjithë si qytetarë. Atë ditë u zgjova herët, sepse kjo përgjegjësi më dha emocione. Ende nuk e dija se kë ta votoja pasi që nga vota ime varej edhe ardhmëria e popullit tim. Këto emocione më zgjuan kureshtjen të dija më tepër për procesin zgjedhor në kohët më të hershme dhe të kuptoja më shumë për mënyrën se si kishte evoluar ky proces. Vendosa të marrë kompjuterin tim të punës

dhe të filloja të hulumtoja. Gjatë hulumtimit mësova shumë gjëra. Kuptova se demokracia ishte një ndër format më të vjetra të qeverisjes. Këtë fakt mund ta keni lexuar edhe në artikullin e kaluar, i cili fliste për demokracinë.

Shumë kohë më parë gratë nuk kishin të drejtën e votës, por vetëm burrat e pasur. Me kalimin e kohës dhe me shumë punë e iniciativa edhe gratë e fituan të drejtën e votës. Vendi i parë, ku ato e fituan këtë të drejtë ishte Zelanda e Re në vitin 1893, më pastaj ishte Australia në vitin 1902, duke vazhduar me shtetet e tjera të Evropës. Por, për gratë e Shteteve të Bashkuara të Amerikës nuk ishte edhe aq e lehtë. Kjo sepse ato në atë kohë nuk definoreshin as si qytetare të këtyre shteteve. Pas Luftës së Parë Botërore, pasi që gratë e kishin provuar veten si patriotë, filluan të trajtoheshin njëjtë si burrat dhe me datë 26 gusht të vitit 1920 fituan të drejtën të merrnin pjesë në zgjedhje. Nuk ishte ky shteti i vetëm që fitoi të drejtën e votës, pasi që edhe në Shqipëri për herë të parë gratë fituan të drejtën e votës në vitin 1946. Shteti i fundit në botë që fitoi këtë të drejtë ishte Arabia Saudite, në vitin 2011. Kjo do të thotë se gratë në këtë shtet votuan për herë të parë në vitin 2015, pas vdekjes së mbretit Abdullah. Duke i lexuar këto informacione, vëreja se kishte kaluar koha dhe kishte ardhur momenti që unë të votoja në qendrën ku unë isha e regjistruar. Tanimë vendosa se kë ta votoja, atë që ishte i duhuri për vendin tim dhe u nisa me shumë vendosshmëri.



Unë dhe shokët e mi të cilët punuam këtë artikull

RËNDËSIA E KUVENDIT NË JETËN TONË

DONAT (14), LORESA (14), BLERON (15), AGNESA (15), ERISA T. (14), ALKETA (14), MEDINA M. (14)



Kurrë nuk e kemi menduar çfarë ndikimi mund të ketë Kuvendi në jetërat tona. Sot, gjatë diskutimit në Punëtorinë e Demokracisë, e kuptuam rëndësinë dhe mënyrën si ndikon Kuvendi tek ne

Në jetë është mirë që gjërat të jenë të sistemuara dhe të rregulluara. Prandaj, ne kemi rregulla pothuajse kudo që jemi. Kemi rregulla në shtëpi, në shkollë, në aktivitete të ndryshme, etj. Gjithsesi, kemi nevojë edhe për rregulla në shtet. Këto rregulla ndryshe njihen si ligje. Mirëpo, pse janë ligjet kaq të rëndësishme? Është shumë e thjeshtë. Përse këmbësorët kalojnë rrugën në vend të caktuar që njihet si „zebrat“? Pse në shkollë shkojmë të gjithë, duke përfshirë të dy gjinitë, pa asnjë dallim racor, kombëtar apo fetar? Pse qytetarët votojnë dhe zgjedhin përfaqësuesit e vet? Pse jemi të lirë të shprehim mendimet tona? Të gjitha këto e shumë më tepër, i kemi falë ligjeve.

Kaq sa janë ligjet të rëndësishme, po aq i rëndësishëm është edhe institucioni prej nga dalin ato. Ky institucion është Kuvendi i Kosovës. Me kënaqësi iu njoftojmë se pikërisht Kuvendi është institucioni më demokratik. Kjo për shkak se qytetarët janë ata, të cilët me anë të votës zgjedhin deputetët. E këta deputetë, të cilët me numër janë 120, miratojnë ligjet.

Në vitin 2013, deputetët miratuan ligjin e duhanit. Ky ligj ndalon konsumimin e duhanit në hapësira të mbyllura. Duke i falenderuar këtij ligji, ne sot hyjmë në lokale dhe restorante të ndryshme dhe ambien-

ti aty nuk është i ndotur nga tymi i duhanit. Në këtë mënyrë, shëndeti ynë është i mbrojtur. Pse mendoni që deputetët miratuan këtë ligj? Për të mirën e gjithë neve. Në anën tjetër, jo vetëm ky ligj, por çdo ligj i miratuar në Kuvend është për të mirën tonë. Fundja, a nuk i zgjedhim deputetët për të na e rregulluar jetën? Sigurisht se po.

Ky funksion i Kuvendit njihet si funksioni legjislativ. Funksion tjetër i Kuvendit është edhe ai përfaqësues, sepse deputetët na përfaqësojnë neve. Kurse, ka funksion kontrollues sepse Kuvendi kontrollon nëse Qeveria po i vë në funksion ligjet. Sot e kuptuam se Kuvendi vërtet luan rol të madh në jetën tonë si nxënës. Prandaj, meqë jemi në rolin e gazetarëve ne i ndamë këto informata me ju që edhe ju të kuptoni se Kuvendi i jep kahje jetës sonë, me ligjet që miraton. Jo më kot ai quhet edhe „Shtëpia e Popullit“.



Gazetarët e demokracisë të bashkuar

KONTRIBUTI PËR TË TJERËT

ADNAN (14), JULINDA (14), MELISA (14)

Qytetarë të dashur, aktiv jeni edhe kur merrni pjesë në procesin zgjedhor duke u bërë pjesë e vendimmarrjes



Unë si përfaqësuese e juaja, ju ftoj që të jeni aktiv për shtetin tonë dhe për demokracinë tonë

A keni menduar se edhe ju si qytetarë mundeni të ndryshoni të ardhmen e shtetit tuaj? Ne nxënësit e klasës së IX-të kemi folur pikërisht për këtë temë. Nëse dëshironi të mësoni më shumë, afëtherë vazhdoni leximin

Këtë artikull dëshirojmë ta fillojmë me shpjegimin e termit qytetar. Qytetar është çdo person, i cili ka leje qëndrimi në një vend, qoftë si vendas i atij vendi apo si refugjat. Por ç'është të thotë të jesh qytetar aktiv?

Qytetar aktiv është ai qytetar, i cili gjen mënyra të kontribuojë për shtetin e vet, në çfarëdo aspekti. Këta qytetarë nuk ngurrojnë të kontribuojnë për shtetin e tyre. Disa gjëra që ata mund të bëjnë janë: të marrin pjesë në zgjedhje, të paguajnë taksat, të bëjnë punë vullnetare, si dhe shumë gjëra të tjera.

Nxënësit e shkollës sonë janë qytetarë aktiv, sepse ata morën përsipër të kryenin një punë vullnetare që ta ndihmojnë një fëmijë të sëmurë. Ishim në klasë,

po mbanim orën e gjuhës shqipe. Në atë kohë erdhi kujdestarja dhe po na njoftonte për një fëmijë që quhej Eron. Kujdestarja na tha se ai kishte një sëmundje të rëndë dhe duhej të mjekohej jashtë vendit. Atij i duhej një shumë e madhe të hollash. Ne si nxënës u ndjemë shumë keq dhe vendosëm t'i ndihmojmë atij. Këtë gjë menduam ta arrinim duke mbledhur të holla. Këtë lajm e postuam edhe në rrjetet sociale. Po ashtu, për Eronin u treguam dhe të afërmve tanë. Për një kohë



Të gjithë mund të jemi qytetarë aktiv

të caktuar mbledhëm disa të holla. Ato të holla ua dërguam familjes së Eronit. Ata u gëzuan shumë dhe na falenderuan për ndihmën që dhamë. Pas një kohe, morëm vesh se Eroni ishte shëruar dhe po kthehej në Kosovë. Ne u gëzuan shumë se ai tanimë ishte një fëmijë i shëndoshë, sikurse ne. E shikoni pra, lexues, me diçka shumë të vogël mund ta ndryshoni jetën e dikujt. Ju ftojmë edhe juve të na bashkoheni!



Këta janë gazetarët prapa këtij artikulli



IMPRESUM

demos ti

Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga

TOKA

Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:
SHFMU „Hilmi Rakovica“
Klasa: IX-2
Vendi: Prishtinë